


EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7882
E premte, 13 shtator 2024
Çmimi 0.50

Spiropali shpreh gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë në fushën e parlamentarizmit | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBËRRITJA E BIZNESEVE TË REJA NË VERI: PROVOKIM, PROGRES, MUNDËSI PUNËSIMI...?

FAQE 4-5



Gjatë këtij viti për herë të parë që nga paslufta më 1999 në shtetitorën kryesore të Mitrovicës së Veriut janë hapur

disa biznese me pronarë shqiptarë. Deri më tash të tillat kanë mundur të vërehen vetëm në Lagjen e Boshnjakëve të këtij

qyteti, që është multietnike. I fundit, më 3 shtator, është hapur një restorant i ushqimeve të shpejta

SISTEMI MODERN I VOTIMIT ELEKTRONIK PËRMIRËSON EFIKASITETIN DHE TRANSPARENCËN E KUVENDIT TË KOSOVËS | F. 3



GRATË NGA KOVOVA DHE RAJONI PROMOVOJNË BASHKËPUNIMIN DHE PAJTIMIN NDËRETNIK PËR NJË ARDHMËRI PAQËSORE DHE EUROATLANTIKE | F. 3



AKTUALE



RAMA: NUK KA PROVA PËR TRANSPORTIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME DREJT TAJLANDËS | F. 2


STUDIMI GJEN SE TË MBIJETUARIT E DHUNËS SEKSUALE PËRBALLEN ME PROBLEME EDHE 25 VJET PAS LUFTËS | F. 6

NJË PJSË E MATERIALIT ARKIVOR QË MBAHEJ ILEGALISHT NGA STRUKTURAT PARALELE NË KOMUNAT NË VERI, TRANSFEROHET NË ASHAK | F. 6

VIZITË FAMILJES SË PRESIDENTIT THAÇI | F. 6



EKONOMI



HAPET THIRRJA PËR SUBVENCIONIM TË PAJISJEVE EFIÇIENTE PËR NGROHJE PËR FAMILJE | F. 8

ODA EKONOMIKE AMERIKANE: QEVERIA TË PËRMBAHET NGA MASAT QË PËRJASHTOJNË KOSOVËN NGA NISMAT RAJONALE | F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama: Nuk ka prova për transportin e mbetjeve të rrezikshme drejt Tajlandës

TIRANË, 12 SHTATOR - Kryeministri shqiptar Edi Rama tha në Kuvend se nga Shqipëria nuk janë transportuar mbetje të rrezikshme në Tajlandë apo Kinë. Kështu ai iu përgjigj opozitës, e cila e ka thirrur në interpelancë për të dhënë shpjegime në lidhje me denoncimin e bërë nga disa organizata ndërkombëtare të mjedisit se dy anije të nisura nga Porti i Durrësit po transportonin rreth 800 tonë me lëndë të rrezikshme drejt Azisë. Sipas kërkesës për interpelancë të opozitës, anijet ishin nisur në korrik, pa konfirmim se vendi pritës, Tajlanda, do t'i pranonte.

“Kur Qeveria e Tajlandës mësoi për llojin e ngarkesës që transportonin anijet, refuzoi t'i pranonte në territorin e saj, siç raporton 'Bloomberg'”, u tha në kërkesën për interpelancë të paraqitur nga opozita shqiptare.

Opozita pretendon se kjo ngarkesë është pluhuri i furës, një produkt mbetjesh i rrezikshëm, që zakonisht vjen nga riciklimi i skrapit të çelikut dhe përmban okside metalike toksike si kadmiumi dhe kromi, që janë të dëmshëm për shëndetin dhe mjedisin.

Në kërkesën e opozitës u theksua se ky lloj pluhuri kërkon trajtim të kushtueshëm dhe për këtë arsye kompanitë që e prodhojnë, kërkojnë t'i shmangin shpenzimet.

Gazmend Bardhi, kreu i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, në opozitë, tha se dy anijet me 100 kontejnerë, që mbajnë rreth 816 tonë mbetje, po kthehen në Durrës.

Kryeministri Rama deklaroi se të gjitha pretendimet e opozitës janë

“televonellë politike, akuza dhe fantazi për ta helmuar popullin shqiptar”. “Të gjitha janë vetëm dyshime. Nuk ka prova dhe as certifikime. Por, organet tona po hetojnë. Në të dyja rastet, atij nga Elbasani, në Durrës dhe në Tajlandë, e nga Kosova në Kinë përmes Durrësit, mallrat janë transportuar me të gjithë dokumentacionin përkatës, përmes linjave konterenike ndërkombëtare me reputacion të padiskutueshëm”, tha ai.

Rama tha se asnjë nga vendet evropiane, përmes të cilave kanë kaluar këto mbetje, nuk kanë pasur kundërshtime.

Rrjeti i Aksionit të Bazelit, BAN, që është ekspert në fushën e çështjeve të drejtësisë mjedisore, ishte i pari që ngriti këtë çështje më 5 gusht. “Nëse konfirmohet se janë mbetje të rrezikshme, sipas dispozitave të Konventës së Bazelit, Traktatit të Kombeve të Bashkuara që rregullon tregtinë e mbetjeve të tjera, kontejnerët mund të sekuestrohen dhe të riatdhesohen në Shqipëri”, u tha në njoftimin e këtij rrjeti.

Më 21 gusht Prokuroria e Durrësit njoftoi se ka nisur hetimet në bashkëpunim me Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit Ekonomik (OLAF). Hetimet kanë nisur mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për “Kontrabandë me mallra të ndaluara ose të kufizuara”. Ndërsa Drejtoria e Policisë së Durrësit referoi materialin hetimor për dyshimet për “Transportim të mbetjeve” dhe “Shpërdorim detyrës”, bazuar në “informacione të marra nga mediet”.



Kjo ngarkesë prej rreth 800 tonësh e ka zanafillën te mbetjet e krijuara gjatë proceseve teknologjike nga aktiviteti i kompanisë turke 'Kurum', në zonën e ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan.

Tri ditë pas Prokuroria njoftoi nisjen e hetimeve, Qeveria shqiptare reagoi përmes dy ministrive, asaj të Infrastrukturës dhe të Turizmit dhe Mjedisit, duke i konsideruar aludime, lajmet në media se nga Shqipëria janë transportuar mbetje të rrezikshme, ndërsa u sqarua se për çfarë mbetjesh bëhet fjalë dhe nga janë nisur. “Në të dyja rastet e përfolura të transportit, nga Elbasani drejt Tajlandës dhe nga Kosova drejt Kinës, mallrat e deklaruar si okside/hidrokside hekuri apo koncentrat zinku, janë transportuar nga Porti i Durrësit drejt porteve evropiane përmes linjave konterenike ndërkombëtare me reputacion të

padyshimtë dhe nuk janë bërë objekte kontrollesh në vendet e BE-së, ku kanë ndaluar dhe janë magazinuar përkohësisht, por janë lejuar të vijojnë itinerarin e tyre”, u tha në reagimin e dy ministrive.

Sipas Qeverisë shqiptare, “nga verifikimet e të dyja proceseve logjistike, si dhe të ngarkesave të ngjashme në të kaluarën, mallra me klasifikim të tillë nuk janë konsideruar asnjëherë si mbetje të rrezikshme nga organet doganore dhe mjedisore”. Në reagim po ashtu u tha se këto mallra nuk janë të ndaluara dhe për pasojë autoritetet nuk mund të kritikohen nga opozita për mosveprim.

Dy ministrinë thanë se “deklarimi i ngarkesës si mall i rrezikshëm apo mbetje e rrezikshme është detyrim i eksportuesit apo importuesit”.

Edhe pse nuk pati asnjë deklaratë nëse këto mbetje do të ktheheshin, Qeveria shqiptare theksoi se “nuk mundet që Shqipëria të pranojë apriori rikthimin e ngarkesave të

tilla, aq më tepër vetëm mbi bazën e dyshimeve e të spekulimeve, pa realizimin e analizave shteruese dhe provave ligjore të besueshme dhe të verifikueshme”.


Duke ftuar që të pritet rezultati i hetimeve në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare Qeveria shqiptare tha se përgjegjësia në çdo rast u takon operatorëve ekonomikë, përkatësisht njërit në Shqipëri e tjetrit në Kosovë.

Opozita në Shqipëri pretendon se kompania “Kurum International” ka shkelur ligjin për mënyrën e përpunimit të mbetjeve të rrezikshme që prodhon, ndërkohë që kompania “Sokolaj” sh.p.k. ka shkelur ligjin, lidhur me transportin e mbetjeve toksike të rrezikshme. Gjithashtu sipas opozitës autoritetet përgjegjëse kane shkelur ligjin duke mosvepruar ndaj këtyre shoqërive private. Opozita akuzoi Qeverinë për mungesë transparence për këtë çështje.

Zelensky kritikon propozimin për paqe të Kinës dhe Brazilit

KIEV, 12 SHTATOR - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, e quajti “shkatërrues” propozimin për paqe të paraqitur nga Kina dhe Brazili, që tha se është krijuar pa marrë qëndrimin e Kievit.

Duke folur në një intervistë për median braziliane, Metropoles, Zelensky tha se propozimi, që u bë publik muajin e kaluar nga Pekini dhe Brazili, ishte “kryesisht proruse” pasi bën thirrje për kompromis nga Ukraina, e cila që nga shkurti i vitit 2022 po lufton kundër forcave pushtuese ruse. “Ata thonë se Ukraina duhet të pajtohet për një kompromis. Çfarë kompromisi? Të heqë dorë nga toka e saj, të harrojë se kush na i vrau njerëzit tanë? Për çfarë kompromisi bëhet fjalë? Kompromisi, në këtë situatë, është i papranueshëm. Ata duan që ne të



harrojmë vrasjet, të harrojmë gjithçka? Mendoj se kjo qasje është shkatërruese”, tha Zelensky gjatë intervistës e cila u publikua më 12 shtator.

“Si mund të propozohet diçka që thotë kjo është nisma jonë, pa biseduar me ne? Dhe Rusia menjëherë del dhe thotë se e mbështet propozimin braziliano-

kinez. Ata nuk janë budallenj. Pse na duhet ky teatër?”.

Më 1 gusht, Kina dhe Brazili bashkërisht publikuan “një konsensus gjashtëpikësh” që synon të sjellë një zgjidhje të qëndrueshme politike për luftën, që Kremlinin nisi dy vjet e gjysmë më parë.

Përmes planit bëhet thirrje për ndërprerje të luftimeve dhe të njihet se dialogu dhe negociatat janë mënyra e vetme për t'i dhënë fund luftës.

Pekini tha se për planin për t'i dhënë fund luftës së Rusisë kundër Ukrainës ka pasur “përgjigje pozitive” nga më shumë se 110 shtete.

Por, Zelensky e kritikoi ashpër këtë nismë dhe në intervistën për median braziliane.

Kina edhe më herët kishte tentuar të ndërmjetësonte një plan të paqes mes Rusisë dhe Ukrainës, pasi në shkurt të vitit 2023 paraqiti një plan 12-pikësh, që shpejt u kundërshtua nga udhëheqësit evropianë.

Presidenti i Brazilit, Inacio Lula da Silva, ka raporte të forta me Kinën dhe po synon që shteti i tij të luaj rol në përpjekjet që lufta në Ukrainë të përfundojë përmes një procesi të paqes.

Në korrik, ministri i atëhershëm i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, tha se shteti i tij do të angazhohej me Rusinë në bisedime të paqes vetëm kur Moskua “të jetë gati të negociojë në mirëbesim”, duke shtuar se “aktualisht nuk ka një gatishmëri të tillë në palën ruse”.

Sistemi modern i votimit elektronik përmirëson efikasitetin dhe transparencën e Kuvendit të Kosovës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të enjten kreun e Misionit të Ambasadës së Dukatiit të Madh të Luksemburgut në Prishtinë, Eric Dietz dhe përfaqësuesit e LuxDev, Agjencisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Luksemburgut, në një takim falënderimi për donacionin që Dukati i Madh i Luksemburgut ka dhënë për Kuvendin, përkatësisht pajisjet digjitale moderne të sallës plenare.

Kryetari Konjufca vlerësoi lart mbështetjen që Dukati i Madh i Luksemburgut ka dhënë për Kosovën në vazhdimësi, përderisa investimin e fundit në Kuvend e konsideroi tejet të nevojshëm, i cili do të ndihmojë në funksionalitetin e mëtejshëm të punës së Kuvendit dhe rritjen e

transparencës.

Duke shprehur kënaqësinë për investimin e realizuar, Eric Dietz, nga ana e tij, theksoi gatishmërinë e shtetit që përfaqëson për ta mbështetur Republikën e Kosovës në të gjitha proceset e saj zhvillimore dhe qeverisjen demokratike.

Pas takimit kryetari Konjufca dhe Dietz vizituan bashkërisht ambientet e sallës plenare dhe panë nga afër pajisjet e instaluar.

Në hapje të seancës plenare Konjufca i informoi deputetët lidhur me instalimin e pajisjeve të reja dhe falënderoi Dietz i cili ishte prezent gjatë hapjes së sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit.

Sistemi i instaluar përfshin njësitë qendrore të kontrollit, njësitë e kryesuesve dhe deputetëve, si dhe një sistem të integruar votimi dhe përkthimi gjuhësor. Karakteristikat kryesore



përfshijnë sistemet e mikrofonit, ekranin e votimit në kohë reale, mbështetjen shumëgjuhëshe, kontrollin e kamerës dhe masa të forta sigurie.

Kompanitë zbatuese kanë punuar ngushtë me përfaqësuesit

e Kuvendit gjatë verës së vitit 2024 për të testuar dhe përshtatur funksionet sipas legjislacionit dhe procedurave të Kosovës.

Me këtë investim Kuvendi i Kosovës kërkon ta përmirësojë menaxhimin e seancave dhe të

ofrojë shërbime votimi dhe përkthimi pa probleme, të sigurt dhe efikas për anëtarët e tij, duke mundësuar kështu qasje pothuajse në kohë reale të publikut në të dhënat e votimit të deputetëve dhe duke përmirësuar llogaridhënien institucionale ndaj tij.

Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të avancuar të e-votimit në sallën plenare është zbatuar nga projekti i LuxDev-it "Rritja e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë" KSV/023. Projekti synon ta katalizojë rritjen e qëndrueshme ekonomike duke nxitur inovacionin, gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin social në një Kosovë më të gjelbër. Në mënyrë të veçantë, projekti përpiket ta stimulojë inovacionin dhe investimet vendase dhe të huaja brenda një ekosistemi të sigurt dhe transparent në mënyrë digjitale.

Shkatërrohen 993 armë të llojeve të ndryshme si dhe pajisje të ndryshme ilegale



Prishtinë, 12 shtator - Policia e Kosovës përmes një ceremonie zyrtare bëri shkatërrimin e një sasive të konsiderueshme të armëve dhe pajisjeve të ndryshme të paligjshme, duke treguar se ky është një hap vendimtar drejt sigurisë më të madhe në Republikën e Kosovës, si dhe duke dërguar një mesazh të gjithë qytetarët, brenda dhe jashtë kufijve tanë, se Kosova është e vendosur për ta mbajtur sundimin e ligjit, për ta ruajtur rendin dhe sigurinë publike si dhe për t'i larguar armët ilegale.

Në këtë ceremoni të shkatërrimit të armëve morën pjesë personalitete të larta nga Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, UNDP-ja dhe Zyra e BE-së, të cilët dërguan mesazhet e tyre te mediet dhe opinioni i gjerë, se duke shkatërruar dhe larguar këto armë nga qarkullimi, po kontribuojmë në krijimin e një mjedisi të sigurt që promovon sigurinë, shpëton jetë

njerëzish si dhe parandalon e shmang tragjedi të mundshme.

Çdo vit Policia e Republikës së Kosovës konfiskon mesatarisht rreth 1 500 armë të llojeve të ndryshme, duke përfshirë numër relativisht të madh të municionit të kalibrave të ndryshëm si dhe të mjeteve të ndryshme plasëse, duke përfshirë edhe eksplozivet artizanale, përderisa në këtë ceremoni me vendim të gjykatës është lejuar shkatërrimi i 993 armëve, prej tyre 372 armë të gjata dhe 621 shkurtra, si dhe pajisje të tjera.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për luftimin dhe parandalimin e veprimtarive të ndryshme kriminale, përfshirë armët ilegale, njëkohësisht iu bënë thirrje të gjithë qytetarëve që të raportojnë dhe të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës, në mënyrë që të dorëzohen dhe të largohen armët ilegale nga duart e qytetarëve.

Hapet konkursi për pranimin e studentëve të UP-së në Qendrën e Studentëve

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës (UP) ka shpallur konkursin për pranimin e studentëve për banim në konvikte dhe për ushqim në mensë për vitin akademik 2024/2025.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 13.09.2024 deri më 19.09.2024.

Studentët të cilët do të aplikojnë për strehim dhe ushqim në Qendrën e Studentëve, aplikimin mund ta bëjnë

përmes sistemit online, në adresat zyrtare të QS, uebfaqes qsrks.gov.net dhe profilin zyrtar Facebook Qendra e Studentëve-Prishtinë.

Në njoftimin për medie thuhet se Qendra e Studentëve këtë vit do të pranojë rreth 4 000 studentë.

Qendra e Studentëve ofron strehim, ushqim si dhe hapësirat për studim.

Po ashtu, studentët e rregullt të UP-së kanë mundësi të aplikojnë veçmas për të fituar të drejtën për t'u ushqyer në Mensën e

Studentëve.

Kriteret për të aplikuar janë të njëjta sikurse për aplikim për konvikt.

Numri i studentëve që do të përfitojnë për ushqim në mensë është 1 500 studentë. "Mënyra e përzgjedhjes së studentëve të cilët do të fitojnë të drejtën për strehim dhe ushqim do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me konkurs. Çmimi do të jetë 35 euro për muaj (20 euro banimi, 15 euro ushqimi)", thuhet në njoftim.





Mbërritja e bizneseve të reja në veri: Provokim, progres, mundësi punësimi...?

Gjatë këtij viti për herë të parë që nga paslufta më 1999 në shëtitoren kryesore të Mitrovicës së Veriut janë hapur disa biznese me pronarë shqiptarë. Deri më tash të tillat kanë mundur të vërehen vetëm në Lagjen e Boshnjakëve të këtij qyteti, që është multietnike. I fundit, më 3 shtator, është hapur një restorant i ushqimeve të shpejta

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Aroma e burgerëve të një restoranti me pronar kosovar nuk i josh shumë qytetarë të Mitrovicës së Veriut. Ngjashëm as shumëllojshmëria e produkteve në një prej dyqaneve po ashtu me pronar shqiptar. Hapjen e tyre rishtas në këtë komunë në veri të Kosovës, Vesna e sheh si "provokim". "E kanë tepruar me ardhjen e tyre këtu. Ky është edhe një gisht i drejtuar në sytë tanë", thotë ajo. Mitrovica e Veriut bashkë me Zveçanin, Zubin Potokun dhe Leposaviqin përbëjnë atë që

njihet si zonë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës. Popullata atje, në ndikimin e Serbisë dhe të strukturave të saj paralele në Kosovë, vështirë u bindet vendimeve të institucioneve në Prishtinë. Këto të fundit, në anën tjetër, kanë marrë së voni disa hapa në përpjekje për ta shtrirë sa më shumë autoritetin atje. Në fund të gushtit ato kanë mbyllur pesë institucione paralele serbe në veri, me arsyetimin se kanë funksionuar jashtë ligjeve të Kosovës.

Paraprakisht kanë kërkuar konvertimin e lejeve të shoferëve, të lëshuara nga Serbia, në ato të Kosovës, kanë ndaluar përdorimin e dinarit serb e të tjera. "Autoritetet e Kosovës nuk po na trajtojnë si qytetarë të klasës së dytë, por të klasës së dhjetë", thotë Milloshi. "Nuk shoh arsye përse duhet blerë në dyqanet e tyre [të shqiptarëve]", thotë ky banor i Mitrovicës së Veriut për "Radion Evropa e Lirë". Elvira, në anën tjetër, thotë se "nuk i pengon të blejë kudo". "Me paratë e mia blej ku dua unë", thotë ajo.

"Në shërbim të çdo qytetari"

Gjatë këtij viti, për herë të parë që nga paslufta më 1999, në shëtitoren kryesore të Mitrovicës së Veriut janë hapur disa biznese me pronarë shqiptarë. Deri më

tash të tillat kanë mundur të vërehen vetëm në Lagjen e Boshnjakëve të këtij qyteti që është multietnike. I fundit, më 3 shtator, është hapur një restorant i ushqimeve të shpejta. "Ne jemi në shërbim të çdo qytetari dhe nuk na intereson përkatësia etnike", thotë për "Radion Evropa e Lirë" menaxherja e restorantit "Heb's", Miradije Gashi. Pasditën e 6 shtatorit, kur ekipi i "REL"-it ishte në ambientet e tij, nuk kishte shumë klientë dhe ata që mund të dëgjoreshin, flisnin shqip. Gashi shpreh bindjen se me kalimin e kohës "aktiviteti i shitjes do të rritet". Ajo tregon se kjo pikë nga rrjeti i restoranteve ka të punësuar gjashtë punonjës shqiptarë dhe dy serbë. Punonjësja serbe, e pranishme atë ditë, nuk pranoi të fliste për REL-in, por Gashi thotë se është e kënaqur me punën e saj.

"Kalojmë shumë mirë... Edhe kur flasim mes vete, flasim serbisht apo anglisht, që ajo të mos ndihet keq, sepse nuk e kupton gjuhën shqipe", thotë menaxherja e restorantit. Më pak se 400 metra larg tij gjendet dyqani "Meridian Express", po ashtu me pronar shqiptar. Me dhjetëra pika të shitjes anekënd Kosovës, të fundit e ka hapur në Mitrovicë të Veriut më 26 gusht. Aktualisht dyqani punëson katër veta nga komuniteti shqiptar dhe dy nga ai boshnjak. Në një deklaratë me shkrim dhënë "Radios Evropa e Lirë", menaxhmenti i tij thotë se "është në proces të zgjedhjes edhe të punëtorëve nga nacionaliteti serb", por nuk tregon se sa është numri i të interesuarve. Pavarësisht prej përpjekjeve të "REL"-it, askush prej klientëve të pranishëm në dyqan pasditën e 6 shtatorit nuk dëshiroi të fliste.



Pacolli: Kjo qeveri karakterizohet nga dështimet marramendëse

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryetari i AKR-së, deputeti Behgjet Pacolli, ka drejtuar kritika për qeverinë Kurti. Ai ka thënë se kjo qeveri karakterizohet nga dështimet marramendëse, ku ka përmendur disa prej tyre. "Nuk ka progres në asnjë fushë, por ka regres gjithandej. Natyra është shkatërruar në përmasa marramendëse; nuk ka asnjë bonifikim të natyrës, por vetëm shkatërrim në të gjitha anët. Prerja masive e pyjeve ka sjellë përmbytje dhe vërshime, ndërsa tokat pjellore janë infektuar nga ujërat fekale të çdo qendre urbane. Mbeturina, si dhe trupat e pajetë të qenve dhe maceve, gjenden kudo. Nuk ka asnjë veprim për pastrimin e lumenjve dhe rregullimin e shtretërve të tyre", ka thënë Pacolli.

Ai ka shtuar se ndotja e ambientit nga tymtarët e termocentraleve të prishura dhe opsolete është katastrofale. "Sëmundjet kanceroze janë në rritje të shfrenuar! Nuk është ky alarm i mjaftueshëm? Nuk ka përparim drejt përfundimit të projekteve të nisura para vitit 2019, por vetëm ngecje. Nuk ka riparim të rrugëve, por vetëm shkatërrim të



mëtejshëm. Këto rrugë të shkatërruara tani rrezikojnë jetën e njerëzve. Nuk ka rritje ekonomike dhe asnjë investim në ndonjë projekt infrastrukturor që do të linte gjurmë për të mirë. Nuk ka investime të huaja, vetëm

tërheqje të investitorëve", ka deklaruar Pacolli.

Ai ka thënë se nuk ka asnjë veprim të organizuar për t'i motivuar qytetarët që të jetojnë dhe veprojnë në Kosovë. "Përkundrazi, po përballemi me

një ikje masive të qytetarëve jashtë vendit. Kemi rritje të kriminalitetit dhe dhunës në familje. Sipas asaj që kemi parë dhe raporteve ndërkombëtare, vitet e fundit karakterizohen nga veprime korruptive të aktorëve të

përfshirë drejtpërdrejt në qeveri. Ka degradim të gjuhës së komunikimit mes qytetarëve të indoktrinuar dhe inkurajuar nga politikat e retorika populiste e qeverisë, dhe urrejtje ndaj atyre që konsiderohen si jo mbështetës të politikave të tyre. Trendi i rritjes së portofolit të miqve të Kosovës është në rënie dhe kjo është pika më shqetësuese për ne!", është shprehur ai.

Pacolli shpreson se sovraniteti i shtetit tonë është shtrirë edhe në veri, për çka ka përgëzuar këdo që ka kontribuar në këtë synim. "Por më duhet të theksoj se Kosova duhet ta shtrijë sovranitetin e saj në veri me kujdes, sepse më shkon mendja se mënyra e zgjedhur nga kjo qeveri mund të jetë e gabuar. Nga praktikat e dimë se gjithçka e arritur me forcë nuk është e qëndrueshme, edhe pse shpresoj të jem gabim në këtë rast! Diskriminimi i familjeve të komuniteteve jo-shqiptare, përmes çmimeve të dy dhe trefishta të teksteve shkollore, nuk është në përputhje me parimet e demokracisë që synojmë..., dhe shumë dështime të tjera!", ka deklaruar Pacolli.

BE-ja e mirëpret ngritjen e aktakuzës për Banjskën

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) e ka mirëpritur vendimin e Prokurorisë së Kosovës për të ngritur aktakuzë kundër disa dhjetëra të dyshuarve për organizim dhe kryerje të sulmit të armatosur ndaj Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë në veri të vendit vitin e kaluar, tha të enjten zëdhënësi i bllokut, Peter Stano.

Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi të mërkurën se ka ngritur aktakuzë ndaj 45 personave - në mesin e tyre edhe Millan Radoičiq - për sulmin e armatosur në Banjskë.

Stano tha se përgjegjësit e sulmit të 24 shtatorit në Banjskë të Zvečanit, ku mbeti i vrarë një polic i Kosovës, do të përballen me pasojat pasi gjyqësori në Kosovë ta shpallë aktvendimin ndaj tyre. "BE-ja ka bërë thirrje vazhdimisht Serbisë që të gjithë të përfshirët në këtë sulm brutal të nxirren para drejtësisë. Ngritja e aktakuzës do të thotë se procedurat gjyqësore tash do të nisnin dhe ne presim të shohim përfundimin e këtij procesi", tha Stano.

I pyetur se a ka qenë Banjska temë e takimit që ambasadorit të BE-së

në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić, të enjten, Stano u përgjigj se BE-ja ia ka përcjellë Serbisë vazhdimisht porosinë e njëjtë, se ajo duhet të bashkëpunojë plotësisht në hetime për t'i sjellë para drejtësisë përgjegjësit për këtë sulm. "Nuk kemi nevojë për takime të veçanta që të përcjellim qëndrimet e BE-së. Ato dihen dhe janë përsëritur disa herë. Presim që Serbia të bashkëpunojë në hetime për këtë rast dhe, po ashtu, t'i mbajë përgjegjës personat e përfshirë. Këtë ua kemi përcjellë disa herë autoriteteve të Serbisë", shtoi ai.



E mundësi të reja punësimi dhe argëtimi për qytetarët e zonës pritëse të ofrojë edhe një biznes tjetër shqiptar nisur nga ky muaj. Zinxhiri i pasticherive "Missini" është duke rinovuar një objekt pranë urës kryesore të Ibrit, që ndan Mitrovicën në jugun e banuar me shqiptarë dhe veriu të banuar me serbë.

Pronari Astrit Misini thotë se do të punësojë deri në 15 punëtorë. "Do të hapim konkurs dhe do të shohim nëse dëshirojnë të aplikojnë edhe qytetarët serbë. Ne jemi të interesuar t'i punësojmë dhe të bashkëpunojmë me ta", thotë Misini për "Radion Evropa e Lirë". Por, këtë disponim nuk e ka edhe Aleksandra - banore në Mitrovicë të Veriut. "Unë nuk blej [në dyqane të shqiptarëve], e as që hyj brenda. Nuk mendoj se e

kanë vendin këtu. Unë blej në dyqanet e njerëzve tanë", thotë ajo.

Regjistrimi i bizneseve dhe subvencionimi i pagave

Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, është zotuar se do t'i mbështesë të gjitha bizneset e reja dhe ato ekzistuese në katër komunat me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Në muajin shkurt, ajo u ka bërë ftesë të gjithë punëdhënësve dhe punëkërkuessve që të regjistrohen në Zyrat e Punësimit në komunat e tyre, për të aplikuar për masën e punësimit "Qeveria për familjet". Kjo masë ofron mundësinë e

subvencionimit të 70 për qind të pagës bazë, me një maksimum prej 350 eurosh, për një periudhë prej gjashtë muajsh.

Në Mitrovicë të Veriut, sipas të dhënave që ofroi Agjencia e Punësimit e Kosovës për REL-in, janë miratuar deri më tash 100 kërkesa për subvencionim - 93 prej të cilave nga komuniteti serb. Nga menaxhmenti i dyqanit të sapohapur thonë se kanë aplikuar tashmë në Zyren e Punësimit në këtë komunë, kurse ata të restorantit dhe pasticherisë thonë se do ta bëjnë një gjë të tillë. Më 9 shtator, kryeministri Kurti ka bërë të ditur përmes një postimi në "Facebook" se Qeveria e tij ka mbështetur punësimin e qindra personave në veri, prej se është lansuar masën "Qeveria për familjet". "Shtatë muaj nga fillimi i skemës, deri më 30 gusht, në

katër komunat në veri kemi ndërmjetësuar dhe mbështetur punësimin e 263 personave, ndërkaq të deklaruara janë edhe 428 vende të lira të punës", ka shkruar Kurti.

Por, për të fituar të drejtën e subvencionimit, bizneset, paraprakisht, duhet të regjistrohen ose të jenë të regjistruara në institucionet e Kosovës.

Nga fillimi i këtij viti, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve e Kosovës (ARBK), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka hapur zyrat e saj në komunat në veri.

Të dhënat që siguroi "REL"-i prej saj, tregojnë se në nëntë muajt e parë të këtij viti janë regjistruar qindra biznese të reja, ndonëse

një numër më i vogël me pronarë shqiptarë.

Të martën Kurti bashkë me disa zyrtarë të kabinetit të tij u panë në restorantin e sapohapur me pronar shqiptar në Mitrovicë të Veriut.

Duke folur për gazetarët në shëtitoren e këtij qyteti, ai tha se "gjithçka që bën qeveria e tij nuk është kundër askujt".

Mbi 200 biznese të reja në veri

Nga janari deri në shtator të vitit 2024 në Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë së Kosovës janë regjistruar 220 biznese të reja në komunat e banuara me shumicë serbe në veri. Prej tyre, 19 janë me pronarë shqiptarë.

Studimi gjen se të mbijetuarit e dhunës seksuale përballen me probleme edhe 25 vjet pas luftës

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Flutura, Fitorja, Melihatja, Arbeni, Yllka... Problemet e këtyre dhe shumë të mbijetuarve të tjerë të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë nuk përfunduan më 12 qershor, Ditën e Çlirimit të Kosovës.

Dhimbjet e tyre janë të ndryshme nga problemet e shëndetit mendor e deri te pasojat afatgjate fizike. Sipas një studimi të publikuar më 12 shtator për pasojat afatgjatë të përdhunimeve të luftës në Kosovë, 86 për qind e të mbijetuarve përballen me probleme të çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD), ndërsa 96 për qind me nivele të larta të ankthit dhe depresionit. "Jeta nuk ia vlen më", ka qenë një fjali në mendjet e mbi 70 për qind të tyre, sipas raportit të organizatës "Medica Gjakova".

Në këtë studim morën pjesë 200 të mbijetuar të dhunës gjatë luftës në Kosovë. Studimi përfshiu 191 gra dhe nëntë burra nga komunitete të ndryshme etnike.

Mirlinda Sada, drejtoreshë ekzekutive e Medica Gjakova,

theksoi se këto probleme të shëndetit mendor përkeqësohen nga izolimi social që përjetojnë shumë të mbijetuar. "Një nga gjetjet më të habitshme nga ky studim është izolimi i vazhdueshëm me të cilin përballen të mbijetuarit. Këto gra dhe burra qëndrojnë në heshtje - jo me zgjedhje, por për shkak të frikës. Frikës nga turpërimi i familjes, frikës se mos braktisen nga komuniteti", tha Sada në konferencën e mbajtur gjatë publikimit të studimit.

Të dhënat e publikuara tregojnë se pothuajse gjysma e të mbijetuarve njohin të mbijetuar të tjerë që nuk kanë folur asnjëherë për përvojën e tyre, ndërsa 70 për qind kanë thënë se i shmangin kontaktet me njerëz shkak i frikës nga stigmatizimi. "Kjo kulturë e heshtjes vazhdon të jetë një pengesë për shërimin e tyre. Këta persona nuk jetojnë thjesht me traumën e asaj që i është bërë gjatë luftës, ata vazhdojnë të durojnë pasojat e stigmës dhe të gjykitimit shoqëror", shtoi Sada. Shumë nga të mbijetuarit e dhunës gjatë luftës në Kosovë i



kanë përshkruar procedurat institucionale për verifikimin e statusit të tyre si të mbijetuar si "të lodhshme" dhe "të frikshme". Shumë kanë thënë se hezitojnë t'i marrin përfitimet që u takojnë në bazë të ligjeve shtetërore nga frika se do të merret vesh publikisht se ata ishin dhunuar gjatë luftës.

Në vitin 2014 Kosova kishte miratuar një ligj për t'ia njohur statusin e viktimës së dhunës seksuale të luftës personave të përdhunuar, duke ua mundësuar kështu atyre një pension ligjor prej rreth 230

eurosh në muaj.

Këto para përdoren prej disa të mbijetuarve edhe për t'i përballuar trajtimet shëndetësore për të cilat kanë nevojë, duke marrë parasysh që vetëm gjashtë për qind e të mbijetuarve e kanë përshkruar gjendjen e tyre fizike si të mirë. Monika Hauser, themeluese e organizatës ndërkombëtare "Medica Mondiale", bëri thirrje që institucionet në Kosovë të ndërmarrin më shumë masa për mbështetjen e të mbijetuarve. "Ende nuk ka mjaftueshëm ndjeshmëri për këtë temë në

mesin e shoqërisë, politikanëve dhe në botën profesionale, as edhe 25 vjet pas luftës. Institucionet nuk duhet t'i lënë gratë vetëm, duhet të marrin përgjegjësi", tha Hauser. Hauser tha se Kosova duhet të ofrojë më shumë shërbime që u ndihmojnë grave t'i përballojnë problemet psikike, shoqërore dhe fizike me të cilat ende përballen si pasojë e dhunës gjatë luftës. Ajo, gjithashtu, tha se është e rëndësishme që komuniteti ndërkombëtar në Kosovë t'i mbështesë organizatat joqeveritare që ofrojnë mbështetje për të mbijetuarit e dhunës.

Numri i saktë i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë nuk dihet. Sipas një raporti të Qendrës Amerikane për Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, kjo shifër arrin deri në 20 mijë.

Gjatë konferencës Hauser theksoi se me probleme të ngjashme përballen edhe të mbijetuarit e dhunës në vende të cilat kanë përjetuar konflikte të ngjashme si në Kosovë, për shembull, të mbijetuarit në Bosnjë-Hercegovinë. (Rel)

Një pjesë e materialit arkivor që mbahej ilegalisht nga strukturat paralele në komunat në veri, transferohet në AShAK

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ka përfunduar transferimi/bashkimi i materialit arkivor, pjesë e fondeve arkivore të Arkivit Ndërkomunal të Mitrovicës/Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK), që mbahej ilegalisht nga strukturat paralele ilegale në komunat Leposaviq, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut.

Materiali arkivor është pranuar/dorëzuar nga Policia e Kosovës në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin për Arkivat dhe aktet nënligjore dhe është vendosur/deponuar në vendruajtjet e AShAK-së.

Procesi i pranimit/dorëzimit është mbikëqyruar nga inspektorët dhe udhëheqësit e AShAK-ut dhe ky material mjaft voluminoz, do t'u nënshtrohet procedurave të përpunimit, rregullimit dhe digjitalizimit dhe përfundimisht,



do t'i bashkohet fondeve arkivore sipas parimeve, kritereve dhe normave profesionale të arkivistikës.

Në masë të madhe materiali

arkivor i pranuar në AShAK-u u takon viteve 1943 - 2000. Megjithatë, AShAK-u, në përputhje me nenin 13 (paragrafi 2) të Ligjit për Arkivat nga Policia e

Kosovës si fondposedues (komunat ilegale nuk kanë status as të fondkrijuesit dhe as të fondposeduesit për shkak të veprimtarisë ilegale), ka pranuar materiale të prodhuara nga aktiviteti i strukturave ilegale paralele në komunat veriore të cilat, megjithëse nuk kanë vlerë të dokumentacionit zyrtar, marrë parasysh që janë krijuar në kundërshtim me rendin Kushtetues të Republikës së Kosovës, mund të shërbejnë si material për nevoja hulumtuese. AShAK-u në përputhje me mandatin ligjor, pas përpunimit dhe trajtimit të këtij materiali, në bashkëpunim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës do të vendosë përfundimisht për formën e administrimit afatgjatë të këtij dokumentacioni.

Pranimi i sasisë së materialit

arkivor nga komunat veriore në AShAK është një e arritur e jashtëzakonshme e gjithë rrjetit zyrtar arkivor në Republikën e Kosovës për shkak se tashmë kemi një progres të ndjeshëm në bashkimin e fondeve arkivore si detyrim i ruajtjes dhe administrimit efikas të kujtesës sonë kolektive, për çka ne e falënderojmë Policinë e Kosovës për mbështetje dhe asistim efikas gjatë procesit të transferimit të kësaj sasive të materialit në arkivin kompetent. "Bazuar në faktin se Ligji nr. 08/L-111 për Arkivat nuk lejon më arkiv të qytetit, ditëve në vazhdim AShAK-u do të marrë masa që arkivat që për momentin funksionojnë me komunat, të barten/transferohen në strukturën e arkivave ndërkomunale sikurse i parashikon Ligji nr. 08/L-111 për Arkivat", ka njoftuar AShAK-u.

Liburn Aliu: Banimi i përbalueshëm dhe social po jetësohet

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se në shkurt të këtij viti kanë hapur thirrjen për aplikim për të gjithë komunat e Republikës së Kosovës për banimin e përbalueshëm dhe social. Ai ka treguar se tashmë kanë

nënshkruar marrëveshjet me katër komuna për të nisur këtë projekt, ndërkaq edhe 13 komuna të tjera janë në proces të nënshkrimit. "Deri tani kemi nënshkruar me komunën e Gjilanit, Podujevës, Pejës dhe Kamenicës", ka thënë Aliu.

Po ashtu, ai ka thënë se për komunat që nuk kanë

aplikuar shumë shpejt do të hapin edhe thirrjen e dytë. "Hap pas hapi drejt realizimit edhe një prej zotimeve tona", ka thënë ministri Aliu.

Kryetari i Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka thënë se kjo komunë do t'i ketë 70 njësi banimi në kuadër të banimit të përbalueshëm për çifte të reja dhe atij social.



Gratë nga Kosova dhe rajoni promovojnë bashkëpunimin dhe pajtimin ndëretnik për një ardhmëri paqësore dhe euroatlantike

PRISHTINË, 12 SHTATOR (ER) - Në Prishtinë është mbajtur Konferenca Rajonale "Gratë që formësojnë të ardhmen paqësore dhe evropiane përmes promovimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe pajtimit në Kosovë dhe në të gjithë rajonin pas konfliktit të Ballkanit Perëndimor".

Kjo konferencë e organizuar nga Lobi Rajonal i Grave të Evropës Juglindore (RWLSEE) dhe Cordaid, e udhëhequr nga Edita Tahiri dhe përkrahur edhe nga Fondi për Paqe dhe Humanitare të Grave (WPHF), përmes bashkëpunimit rajonal promovoi rëndësinë e marrëdhënieve ndëretnike dhe pajtimin etnik në Ballkanin Perëndimor të së kaluarës tragjike.

Të pranishëm ishin edhe zëvendësambasadorja amerikane në Kosovë, Anu Prattipati, ekspertja për barazi gjinore Anne Kwakkenbos, shefi i OSBE-së, Michael Davenport, shumë ekspertë ndërkombëtarë, gra nga katër komunat veriore dhe të gjitha komunat e tjera anembanë Kosovës.

Konferenca u hap me fjalët përshëndetëse nga Edita Tahiri, kryetare e RWLSEE, Anne Kwakkenbos, eksperte për çështjet gjinore Cordaid dhe Anu Prattipati, e ngarkuar me punë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë.

Edita Tahiri në fjalën e saj tha se është kënaqësi të hapin këtë konferencë Rajonale të Grave Lokale për Ndërtimin e Paqes dhe Pajtimin Etnik që së bashku ta ndërtojnë paqen, barazinë gjinore dhe pajtimin etnik për një të ardhme më të mirë dhe euroatlantike për të gjithë në Kosovë dhe në të gjithë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor që kaluan luftëra tragjike ku, sipas saj, "pasojat e të cilave ende i vuajmë, por angazhimi ynë për të tejkaluar këto pasojat dhe ndërtuar ardhmëri të ndritur është i nevojshëm dhe duhet ta bëjmë".

Anu Prattipati në fjalën e saj theksoi se marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimi etnik janë thelbësore për ndërtimin e paqes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, edhe pse nuk është e lehtë, por është e mundur të arrihet demokracia multietnike.

E ngarkuara me punë e Ambasadës Amerikane, Anu Prattipati, tha se marrëdhëniet ndëretnike janë thelbësore për nxitjen e

mirëkuptimit, respektit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë midis komuniteteve të ndryshme. Ato mund të ndihmojnë në kapërcimin e hendeqeve, uljen e tensioneve dhe promovimin e paqes. Në fund ajo tha: "Të gjithë së bashku për paqen dhe të ardhmen euroatlantike".

Anne Kwakkenbos në fjalën e saj të hapjes së konferencës theksoi se ajo dhe Cordaid mbështesin fuqishëm iniciativën rajonale të RWLSEE për ndërtimin e paqes dhe fuqizimin e grave. Ajo më tej tha se gratë janë jetike për promovimin e paqes dhe pajtimin. "Roli i tyre në promovimin e dialogut ndëretnik është i domosdoshëm për krijimin e stabilitetit. Pavarësisht prej sfidave të vazhdueshme, përpjekjet e tyre po hedhin bazat për një të ardhme më të barabartë në rajon", tha ajo.

Konferenca Rajonale e Grave Lokale për Ndërtimin e Paqes dhe Pajtimin Etnik kishte për qëllim ta trajtojë çështjen e marrëdhënieve të tensionuara ndëretnike dhe procesin e ngecur të pajtimit në Kosovë, por edhe në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor. Ai shqyrtoi pengesat për rritjen e bashkëpunimit ndëretnik dhe perspektivat për avancimin e pajtimit ndëretnik në rajonin më të gjerë, duke theksuar rëndësinë e bashkëjetesës multietnike për ndërtimin dhe zhvillimin e paqes.

Duke u fokusuar në rolet dhe perspektivat e grave si shtytëse thelbësore të ndërtimit të paqes dhe promovuesve të dialogut, Konferenca kishte për qëllim t'i lehtësonte diskutimet midis grave shumicë shqiptare dhe minoritetit serb në Kosovë me pjesëmarrjen e grave nga rajoni, nga shtatë vende të fokusit të RWLSEE (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia). Qëllimi ishte të ndërtoheshin ura ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike, duke promovuar zgjidhjet bashkëpunuese dhe forcimin e përfshirjes së grave vendase në paqe, siguri, drejtësi dhe proceset vendimmarrëse, të gjitha duke nxitur bashkëpunimin rajonal për t'i përforcuar zërat e grave dhe vajzave në ndërtimin lokal të paqes përfshirëse gjinore.

Pjesëmarrësit e konferencës u përfshinë në diskutime të gjalla dhe frymëzuese duke paraqitur pikëpamjet, idetë, përvojat dhe



rekomandimet e tyre në lidhje me objektivat e Konferencës.

Objektivat e përgjithshme ishin promovimi i bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik në Kosovë, duke ofruar hapësirë për dialog për gratë lokale të komuniteteve etnike shumicë dhe pakicë përmes ndërmjetësimit rajonal të paqes të RWLSEE për diskutime, ndërveprime dhe ndërtim të ndërsjellë besimi, për të qenë në gjendje të adresimi i çështjeve me interes të ndërsjellë, sfidave dhe mënyrave që çojnë drejt zgjidhjeve për zhvillimin e komunitetit, bashkëjetesën paqësore ndëretnike dhe pajtimin ndëretnik me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e grave nga rajoni, si një rrugë përpara drejt një të ardhmeje paqësore dhe evropiane që çojnë drejt zgjidhjeve për zhvillimin e komunitetit, bashkëjetesën paqësore ndëretnike dhe pajtimin ndëretnik me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e grave nga rajoni, si një rrugë përpara drejt një të ardhmeje paqësore dhe evropiane me gratë që kanë rol udhëheqës, gjithashtu si forcimi i pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet në proceset e paqes, sigurisë dhe pajtimit, duke promovuar agjendën e WPS në të gjitha nivelet.

Po ashtu që gratë lokale të Kosovës të bëjnë një përparim në marrëdhëniet ndëretnike të tensionuara së fundi në mes shumicës shqiptare dhe pakicës serbe për shkak të disa faktorëve të identifikuar dhe të promovojnë së bashku stabilitetin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të paqes përmes bashkëpunimit ndëretnik dhe pajtimit me një rol aktiv të grave, duke çuar te e ardhmja paqësore gjithëpërfshirëse gjinore, si dhe forcimi i pjesëmarrjes së barabartë të

grave në proceset e paqes, të sigurisë në nivel lokal dhe kombëtar, duke theksuar se qeverisja lokale dhe kryetarët e bashkive nuk mund të jenë vetëm në duart e burrave, por pushteti duhet të ndahet midis burrave dhe femrave. Përveç kësaj, duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjellë, ndërtimin e besimit dhe dialogun e hapur për heqjen e pengesave drejt harmonisë dhe pajtimit ndëretnik.

Konferenca Rajonale e Grave Lokale për Ndërtimin e Paqes dhe Pajtimin Etnik vazhdoi me diskutime në panel. Temat e trajtuara nga panelet ishin: Gjendja e marrëdhënieve ndëretnike në vendet e Ballkanit Perëndimor nga perspektiva e grave: Praktikimet më të mira dhe mësimet e nxjerra; Avancimi i marrëdhënieve dhe pajtimit ndëretnik në nivel rajonal dhe lokal: Sfidat dhe perspektivat; Dialogu i Brukselit, Integrimi në BE dhe Pajtimi Etnik në Ballkanin Perëndimor me rolin udhëheqës të grave; Dialogu ndëretnik i grave ndërmjet shumicës shqiptare dhe pakicës serbe në Kosovë - "Forcimi i pjesëmarrjes së grave lokale në proceset e paqes, sigurisë, vendimmarrjes dhe pajtimit përmes bashkëpunimit rajonal: Zëri Rajonal i Grave dhe Vajzave për Ndërtimin e Paqes Lokale Gjithëpërfshirëse Gjinore.

Konferenca vazhdoi me seancat e grupeve të punës për përgatitjen e rekomandimeve, të cilat do të diskutohen në seancat plenare me qëllim ndërtimin e një grupi rekomandimesh konkrete që do të

miratohen nga pjesëmarrësit për t'u ndarë me politikëbërësit, vendimmarrësit në nivel kombëtar, rajonal dhe global.

Konferenca mbledhi së bashku gra vendase nga dhjetë komuna multietnike të Kosovës, anëtarë të Komitetit Drejtues të RWLSEE nga shtatë vende të fokusit (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia), përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë Cordaid dhe WPHF (Gratë në Fondi Humanitar i Paqes)/WPHF Dritarja e Reagimit të Shpejtë dhe e organizatave dhe agjencive ndërkombëtare, ekspertë të UNWomen, studiues, praktikues.

Të pranishëm në konferencë ishin: znj. Edita Tahiri, znj. Sonja Biserko, znj. Nada Drobnjak, znj. Irina Pockova, znj. Memnuna Zvizdic, znj. Vesna Škare Ožbolt, znj. Gordana Čović, znj. Flora Macula, znj. Time Kadrijaj, znj. Xhevahire Izmaku, znj. Slavica Strikokvic, znj. Savka Todorovska, znj. Anne Kwakkenbos, znj. Anu Prattipati, z. Michael Davenport, znj. Cornelia Taylor, z. Xavier Rouard, znj. Ora Prelvukaj, znj. Charle Cuellar, z. Lulzim Peci, z. Elmi Reçica, znj. Lirije Kajtazi, z. Erden Atiq, znj. Katarina Adjanic, znj. Marina Bogojevic, znj. Elga Mitre, znj. Emona Salih, znj. Veprorë Shehu, znj. Biljana Zarkovic, znj. Snezana, z. Rikalo, znj. Olivera Millosheviq, znj. Hasime Tahiri, znj. Radmila Kapetanovic, znj. Jelena Aksentijevic dhe stafi mbështetës i RWLSEE znj. Diana Cekaj-Berisha dhe znj. Arbëresha Dedinja.



Hapet thirrja për subvencionim të pajisjeve eficiente për ngrohje për familje


EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministria e Ekonomisë ka hapur thirrjen publike për subvencionim të pajisjeve eficiente për ngrohje për shtëpi dhe banesa të financuara nga Bashkimi Evropian në Kosovë (BE).

Masat e prezantuara synojnë mbështetjen e konsumatorëve familjarë, në veçanti konsumatorët në nevojë si investimi në instalimin e pajisjeve eficiente për ngrohje, e të cilat përfshijnë: pompë termike, kondicioner/ klimë eficiente, kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket), dhe stufa individuale me biomasë.

Vlera e subvencionimit për një pajisje pompë termike është 30 % e vlerës investive, apo deri në 2 000.00 euro.

Kondicioner/klimë, vlera e subvencionimit për një pajisje është dyzet 40 % e vlerës investive, apo deri në 400.00 euro. Për prindërit vetushqyes dhe qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria 1 dhe 2) subvencionohet 60 % e vlerës



investive dhe deri në 550.00 euro. Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket), subvencionohet 70 % e vlerës investive dhe deri në 1

200.00 euro. Ndërsa stufa individuale me biomasë, vlera e subvencionimit për një pajisje është 70 % e vlerës

investive dhe deri në 435.00 euro. Për prindërit vetushqyes dhe qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale

(kategoria 1 dhe 2) subvencionohet 90 % e vlerës investive, apo deri në 560.00 euro.

Ministria e Ekonomisë ka njoftuar se pajisjet që blihen para datës së shpalljes së thirrjes nuk do të subvencionohen. “Qytetarët që kanë qenë përfitues të subvencionit për blerjen e pajisjeve ngrohëse eficiente, të njëjës nga thirrjet publike: thirrjes publike nr. 02/2022, me datë 06.10.2022; thirrjes publike nr. 03/2022, me datë 18.11.2022, ose; thirrjes publike nr. 03/2023, me datë 22.09.2023, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për subvencionim për pajisjet ngrohëse eficiente në kuadër të thirrjes publike nr. 05/2024”, ka njoftuar Ministria e Ekonomisë.

Afati për aplikim është 30 ditë kalendarike nga dita që hapet thirrja, pra deri më 11 tetor të vitit 2024, ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje. “Aplikimet e pranuar do të shqyrtohen bazuar në parimin kush aplikon i pari shërbehet i pari, andaj inkurajoheni të aplikoni sa më herët”, ka njoftuar Ministria e Ekonomisë.

Oda Ekonomike Amerikane: Qeveria të përmbahet nga masat që përjashtojnë Kosovën nga nismat rajonale

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë përmes një njoftimi për medie i ka vlerësuar shqetësues paralajmërimet e ditëve të fundit lidhur me mundësinë e përjashtimit të Kosovës nga nismat e bashkëpunimit rajonal për shkak të qasjes aktuale.

Duke përsëritur thirrjen e saj ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës për shfuqizim të masës që pengon lëvizjen e lirë të mallrave nga shtetet anëtare të marrëveshjes CEFTA, Oda Amerikane thekson se një masë e tillë rrezikon jo vetëm të arriturat e shënuara përgjatë viteve, por kërcënon prospektet e ardhshme të Kosovës, të cilat do të rezultojnë nga bashkëpunimi



ekonomik. “Oda Amerikane rithekson se marrëdhëniet e mira fqinjësore janë parakusht për realizimin e aspiratave për integrim euro-atlantik, ndërsa

qasja aktuale e cila mund të çojë në izolim ekonomik e politik, do të sillte pasoja të paparashikueshme për Kosovën, rritjen ekonomike dhe mirëqenien e qytetarëve, aq

më tepër që paralajmërimet e tilla nuk duhet të shihen si retorikë boshe, meqë tashmë Kosova është duke u ballafaquar me masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian, të cilat rezultojnë në mundësi të humbura të zhvillimit ekonomik dhe përparimit social”, thuhet në njoftimin e OEAK-ut.

OEAK-u thekson se duke qenë të vetëdijshëm për barrierat e shumta me të cilat ballafaqohen prodhuesit nga Kosova në përpjekjet për plasimin e produkteve të tyre në tregun rajonal, Oda Amerikane përsërit qëndrimin e saj se këto sfida duhet të adresohen përmes mekanizmave të paraparë në kuadër të aranzhimeve për tregti të lirë dhe përmes dialogut të

hapur dhe konstruktiv. “Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kërkon edhe një herë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta konsiderojë rëndësinë e koordinimit me të gjitha shtetet aleate dhe të përmbahet nga veprimet që kanë efekt të kundërt në realizimin e synimeve të përbashkëta për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar, tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe përshtetimin e rritjes ekonomike. Investitorët seriozë duhan të investojnë nga tregjet e mëdha dhe të integruara, ndërsa Kosova duhet të pozicionohet në mënyrë të duhur për ta realizuar potencialin e saj të plotë”, thuhet në njoftimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Posta e Kosovës hap një pikë të re në Prishtinë

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë të enjten është hapur një zyrë e re e Postës së Kosovës, e 145-ta me radhë. Në hapje mori pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Kurti këtë pikë e shfrytëzoi edhe për dërgimin e një kartoline.

Kryeministri Kurti ka thënë se Posta e Kosovës po ngrihet duke ofruar shërbime cilësore dhe të shpejta e më të lira. “Pika e 145 në Republikën e Kosovës, njëkohësisht edhe pika më e mirë në kryeqytetin e Republikës në Prishtinë. Nëse dikush ka pasur dilema se cili është vendi më i mirë në Prishtinë, është pikërisht pika e re e Postës së Kosovës. Posta e Kosovës është duke u

ngritur, duke i bërë shërbimet më cilësore e më të shpejta e më të lira, dhe duke qenë gjithëherë pranë qytetarëve tanë pa dallim”, ka theksuar Kurti.

Ndërsa ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, u shpreh se në Kosovë tashmë ka një menaxhim më të mirë dhe përkrahje më të madhe nga qeveria për ndërmarrjet publike.



VIZITË FAMILJES SË PRESIDENTIT THAÇI



I shoqëruar sot nga dy miq të mi të çmuar, shkrimtarë dhe gazetarë të hershëm, patrioti Riza Grajçevci dhe Mustafë Xhemaili vizitua bacën Haxhi, i cili na rezervoi një mikpritje shumë të ngrohtë vëllazërore, nga ky baba stoik, nga i cili ka dalë presidenti historik i Kosovës, Hashim Thaçi!

Prindërit e presidentit kanë peshën dhe mërzinë më të madhe mbi supet e tyre, sepse djali tyre dhe i Kosovës gjendet padrejtësisht në Gjykatën e Hagës. Baci Haxhi nuk besoj se Gjykata e Hagës bën padrejtësi. Ne jemi këtu për t'i thënë botës demokratike, por edhe kësaj gjykate se ne kemi plagët e mëdha të historisë, që akoma nuk e kemi marrë veten nga gjenocidi turko-serb të ushtruar kundër nesh.

Por, ne nuk mund të heshtim. E kemi kuptuar që të barabartë njerëzimi ishin vetëm në varreza, e ne do ta ngritim zërin me mjete demokratike që të na ktheni presidentin në Atdhe.



Shteti ynë i ri, me një demokraci frazhile dhe adoleshente në politike, ka bërë që të tjerët po abuzojnë me ne, por besoj se tani ne po rritemi me vlerat e lirisë e demokracisë dhe do të marrim vendin e merituar në koncertin e popujve evropian.

Fati i presidentit është i lidhur me Republikën dhe ne me presidentin. Besojmë se e drejta është në anën tonë dhe përpjekjet tona për liri do të fitojnë mbi tentativat e njollës së lirisë tonë që vërtet nuk e merituaam.

Liri presidentit Hashim Thaçi, i cili i mungon familjes dhe Kosovës!!!

(Sali Bislimi - veprimtar, Burojë / 12 shtator)





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Batatina: Jam gati t'i ndihmoj klubet për rregullimin e fushave me bari natyral



Trajneri Tahir Batatina duket i palodhshëm me punët që i kryen në skuadrën e Llapit. Ai së fundmi ka dalë me një ide mjaft interesante ku është i gatshëm t'i ndihmojë klubet e tjera për rregullimin e fushave me bari natyral

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Stadiumi "Zahir Pajaziti" i skuadrës Llapi e ka fushën më të mirë në futbollin e Kosovës dhe për këtë pa asnjë mëdyshje meritë më të madhe ka familja Batatina që e menaxhon klubin llapjan.

Trajneri i kësaj skuadre, Tahir Batatina, nëpërmjet një postimi në "Facebook" u ka ofruar ndihmë klubeve të tjera që t'i ndihmojë klubet rreth zgjedhjes së këtij problemi. Ai ka thënë se pa asnjë përfitim personal është i gatshëm të ndihmojë në rregullimin e fushave me bari natyral. "Duke marrë parasysh problematikën e infrastrukturës sportive në Kosovë, veçanërisht të fushave të futbollit,

dua të bëj diçka të mirë për futbollin dhe për futbollistët e talentuar që Zoti na ka dhuruar. Deri tani nuk kam dashur të flas për këtë pjesë, por tani jam i gatshëm t'i ndihmoj të gjitha klubet sportive në koordinim me ministrinë, kuvendet komunale dhe Federatën e Futbollit, për t'i rregulluar fushat me bari natyral, nga zero deri në përfundim, pa asnjë fitim personal - vetëm për t'i mbuluar shpenzimet e ekipit tim", ka shkruar Batatina. Trajneri karizmatik më pas ka thënë se klubet nuk kanë nevojë të shpenzojnë milionat, pasi me ato mjete mund të ndriçojnë edhe dhjetë fusha të Superligës. "Këtë dua ta bëj për hir të futbollit të Kosovës. Në këtë mënyrë nuk do të keni nevojë të shpenzoni miliona dhe ato mjete mund të investohen

për ndriçimin e 10 fushave të Superligës. Ekipi që kam krijuar në kompaninë time ka përvujtën e duhur dhe një staf profesional për të ndërtuar fushat sipas standardeve të UEFA-s dhe FIFA-s, me një kosto shumë të ulët - vetëm për ta ndihmuar futbollin e Kosovës. Nuk duhet të angazhohen kompani që nuk kanë ide të qarta për ndërtimin e fushave sportive", ka shtuar ai.

Jo pak telashe ka pasur edhe fusha në stadiumin "Fadil Vokrri", e cila është mbyllur për 25 ditë. Pas vizitës në këtë stadium të ministrit të Sportit, kryetarit të FFK-së dhe ekspertit të UEFA-s, Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se fusha do të mbyllet për shkak të kompletimit të fushës hibride me rritjen e barit natyral.

SHKURT

Desmond Cambridge, MVP i Superkupës së Kosovës

KB Trepça është fituese për të dytin vit me radhë e Superkupës së Kosovës në basketboll. Në finale mitrovicasit mposhtën Sigal Prishtinën me rezultat 89-73.

Ndërkohë MVP i finales u shpall Desmond Cambridge Jr, basketbollisti i Trepçës. Ai pati performancë të shkëlqyer duke mbyllur ndeshjen me 15 pikë, katër kërcime e dy asistime. Kështu edhe fitoi çmimin si lojtar më i vlefshëm i eventit. Cambridge është transferuar këtë verë nga skuadra mitrovicase.

Çuni i bashkohet Dakut te Rubin Kazani

Marvin Çuni është zyrtarisht pjesë e Rubin Kazanit në Rusi, duke iu bashkuar kështu ekipit të Mirlind Dakut. 23-vjeçari mbylli kështu aventurën në kampionatin italian te skuadra e Frosinones. Për transferimin e Çunit, Rubin Kazan, shpenzoi plot dy milionë euro, me shpresën që sulmuesi shqiptar do të ketë të njëjtin impakt si Mirlind Daku, që është shndërruar në një lider. Sulmuesi ka firmosur një kontratë katërvjeçare, pra të vlefshme deri në vitin 2028.

Ferizaj përforcohet me brazilianin Souza

Skuadra e Ferizajt është përforcuar me futbollistin brazilian Guilherme Souza. Ky i fundit luan në pozitën e qendërmbrojtësit dhe karrierën e ka filluar në skuadrën e famshme braziliane Corinthians. "FC Ferizaj ka kënaqësi t'ju njoftoj se ka arritur marrëveshje me mbrojtësin e qendrës, brazilianin Guilherme Souza. Mbrojtësi ynë karrierën e ka filluar te grupmoshat e skuadrës së njohur braziliane Corinthians, për të vazhduar te Fluiminense dhe ekipi i njohur portugez, Gil Vicente. Me ardhjen e Guilhermes kemi plotësuar një boshllëk në vijën e fundit, e që kjo ishte edhe kërkesë direkte e kryetrajnerit Abazi. Mirë se vjen, Guilherme", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

Kosova me tre xhudistë në Grand Prix-in e Zagrebit

Kosova do të paraqitet me tre xhudistë në Grand Prix që zhvillohet në Zagreb të Kroacisë, që mbahet me datë 13-15 shtator 2024. Atje do të marrin pjesë 4 kontinente, 40 shtete dhe 326 garues. Nga Kosova atje do të garojnë: Erza Muminoviq në kategorinë -52 kg, Flaka Loxha - 57 kg dhe Dardan Cena (-73 kg). Muminoviq dhe Loxha ndeshen nesër, kurse Cena ndeshet ditën e shtunë. Bashkë me garuesit ka udhëtuar trajneri Fatos Tabaku.

Stadiumi 'Fadil Vokrri' mbyllet për 25 ditë

Prishtinë, 12 shtator - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, vizituan stadiumin "Fadil Vokrri" së bashku me ekspertët e fushave nga UEFA.

Dr. Tugrul Hocaoglu, doktor i agronomisë dhe ekspert i fushave nga UEFA, i cili ka qenë përgjegjës për stadiumet e finales së Ligës së Kampionëve, shpjegoi se bari natyral është në proces rritjeje dhe

për këtë është e nevojshme kohë. Momentalisht moti që po mbretëron është në favor të këtij procesi dhe puna do të kryhet intensivisht për një muaj. "Në 25 ditët e ardhshme, duke filluar nga

dita e sotme, në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë, nuk do të ketë asnjë aktivitet sportiv, as ndeshje as seanca stërvitore, sepse fusha do të punohet për ta arritur qëllimin e të gjithëve, kompletimin e fushës

hibride me rritjen e barit natyral në të", thuhet në njoftimin e FFK-së. Aktivitetet në fushën e stadiumit "Fadil Vokrri" do të rikthehen për ndeshjen e radhës të Përfaqësueses së Kosovës më 15 tetor.

Rossi nuk e fal Marquezin: Piloti më i pistë, luftoi që unë ta humbisja titullin

URBINO, 12 SHTATOR - Valentino Rossi nuk është në gjendje të fshijë lehtësisht nga kujtesa e tij zhgënjimin e kampionatit botëror 2015 të MotoGP, humbur në "fotofinish" kundër Jorge Lorenzo. Sidomos për sjelljen e Marc Marquezit, të cilësuar shpesh si jo korrekte në dëm të italianit e në favor të

patriotit të tij. "Ta krahasosh zhgënjimin që ndjeva në 2006-n me atë që ndodhi në 2015-n është e pamundur. Në vitin 2006 bëra një gabim, Hayden fitoi titullin dhe ky është sporti. 2015 është ndryshe..." shprehet Rossi. Pothuajse dhjetë vjet pas incidentit, Rossi nuk është në

gjendje ta gëlltisë zhgënjimin, duke sulmuar Marc Marquez: "Mendimet e mia për Marquezin, pothuajse 10 vjet më vonë, janë se ai është një pilot shumë i fortë, një kampion shumë agresiv". "Por në 2015-n shkoi përtej vijës, sepse nëse nga ana sportive, nëse je pilot i keq, garon në mënyrë të pandershme

pasi dëshiron të fitosh. Por, asnjë pilot i motoçiklizmit nuk ka luftuar për të bërë të mundur që të humbasë një pilot tjetër", u shpreh Rossi. "Kjo është ajo që heq vijën e kuqe. Kurrë nuk ka qenë dikush kaq i ndyrë sa për të bërë dikë tjetër të humbasë. Kjo ishte shumë e ulët", u shpreh Valentino Rossi.



Zidane: Ronaldo është më i miri me të cilin kam luajtur

MADRID, 12 SHTATOR - Legjenda e Real Madridit, Zinedine Zidane, ka zbuluar bashkëlojtarin më të mirë që ka pasur ndonjëherë gjatë karrierës së tij të shkëlqyer si lojtar dhe ai është Luiz Nazario de Lima Ronaldo. Duke folur për Goal, përmes Bleacher Report, Zidane ka thënë se Ronaldo ka qenë bashkëlojtari më i mirë me të cilin ka luajtur. "Gjithmonë kam menduar se Ronaldo ishte më i miri sepse kam luajtur dhe stërvitur me të. Ai është ndoshta më i miri me të cilin kam luajtur ndonjëherë. Ai bëri gjithçka që donte me topin dhe nuk kishte asnjë dobësi. Kur vendosi të shprehej me topin, bëri gjithçka që donte. Nga pikëpamja teknike, asnjë lojtar nuk më ka bërë më shumë përshtypje se Ronaldo", ka thënë Zidane. "Nuk kishte asnjë sistem



apo taktikë që mund ta ndalonte atë. Kështu ndodhi me disa lojtarë, dhe ai ishte njëri prej tyre - ishte i shpejtë dhe i zoti. Kur Ronaldo kishte topin, ai vraponte me një shpejtësi prej 2000 miljesh në orë. Në shumicën e rasteve, ju jeni të

shpejtë pa top. Ai ishte i shpejtë me topin", ka deklaruar Zidane, i cili luajti me Ronaldon për katër vjet midis 2002 dhe 2006 te Real Madridi. Dyshja ikonë ishte pothuajse e pandalshme në La Liga duke fituar kampionatin në vitin 2003.

Verstappeni punon orë të tëra në simulator për garën në Baku

BAKU, 12 SHTATOR - Red Bulli nuk ka fituar në gjashtë garat e fundit dhe McLareni tani është në prag të rokadës së madhe për ta marrë kreun e renditjes në botërorin e konstruktorëve. Sfidat e radhës në Formula 1 është këtë fundjavë në Baku, në pistën qytetase të Azerbajxhanit, ku gjithçka mund të ndodhë. Max Verstappeni kryeson ende renditjen për pilotë merr 62 pikë epërsi ndaj Lando Norris. Duke folur për sfidën e radhës, ai shtoi: "Këtë javë u ktheva në fabrikë me ekipin dhe punova në simulator në funksion të sfidës së radhës. Monza ishte një garë e vështirë dhe prioriteti ynë është të rikthehemi konkurrues". "Ekipi ka punuar shumë për t'i përmirësuar problemet që kemi përjetuar me makinën në garat e fundit. Është gjithmonë një sfidë e mirë të vish në Baku dhe është një pistë e veçantë, sepse edhe pse është një qark rrugësh, ka vija të gjata. Do të shohim se çfarë na pret



fundjava", ka thënë Verstappeni. "Do të kërkoj një përpjekje ekipore, por ne kemi besim se po shkojmë në drejtimin e duhur. Baku është gjithmonë një pistë argëtuese. Mua personalisht më

pëlqejnë garat atje. Qarqet rrugore i përshtaten stilit tim dhe më pëlqen ta sfidoj veten. Do të jetë interesante të shohim se si reagon makina", ka shtuar holandezi.

SHKURT

Hysaj, shqiptari më i paguar në Serinë A

Calcio dhe Finanza, revista e specializuar për ekonominë në Itali, ka bërë një renditje sa iu takon pagave të futbollistëve dhe shumën që klubet shpenzojnë në total për lojtarët që kanë në kontratë. Më i paguari në Serinë A është Dusan Vlahović, sulmuesi që Juventus e paguan 12 milionë euro në sezon. Në total klubet e Serisë A paguan më shumë se 1 miliard euro (përfshi taksat) për rrogat e futbollistëve. Sa iu takon futbollistëve shqiptarë, Elseid Hysaj i Lazios është më i paguari. Sipas të dhënave të publikuara nga faqja e specializuar "Calcio e Finanza" mbrojtësi 30-vjeçar merr 2 milionë euro në sezon nga Lazio. Edhe pse mbeti jashtë listës klubi është i detyruar ta paguajë atë. Pas Hysajt janë Berat Gjimshiti i Atalantës dhe Kristjan Asllani i Interit me një rrogë vjetore 800 mijë euro neto secili. Ardian Ismajli merr 700 mijë euro tek Empoli, ndërsa Ylber Ramadani paguhet 450 mijë nga Lecce. I sapoardhuri Alen Sherri ka firmosur për 150 mijë euro në vit te Cagliari, ndërsa më pak i paguari është mesfushori Medon Berisha. Ai merr 120 mijë euro nga Lecce.

Interesimi i Realit për Rodrin, reagon City

Real Madridi ka vënë në shënjestër një tjetër yll të futbollit botëror, Rodrin e Manchester Cityt. Interesimi i gjigandëve spanjoll me sa duket tremb "qytetarët" të cilët janë vënë në lëvizje për ta blinduar yllin e ekipit. Rodri ka një kontratë të vlefshme deri në 2027, por drejtuesit e Cityt janë të gatshëm t'i ofrojnë një kontratë të re deri në 2030, sigurisht me kushte ekonomike të përmirësuar ndjeshëm. Sipas "Ok Diario", shekëti e City i ofrojnë mesfushorit spanjoll 23,5 milionë euro në sezon, afro 450 mijë euro në javë. Nëse Rodri do të pranonte këtë kontratë do të shndërrohej në lojtarin më të paguar te klubit duke kaluar edhe dy yjet e tjerë si De Bruyne dhe Haaland. Rodri nuk e ka fshehur asnjëherë dëshirën e tij për t'u bashkuar në një ditë me Real Madridin, të rikthehet në Spanjë ku më herët ka veshur fanellën e Atletico Madridit dhe Villarealit.

Mbappe ia kërkon borxhin PSG-së

U largua me parametër zero, por jo gjithçka paska marrë fund. Kylian Mbappe dhe Paris SG nuk mund të ndahen kaq lehtë nga njëri-tjetri, dhe ja ku nis seria e re e telenovelës mes tyre. Mediet ndërkombëtare shkruajnë dhe raportojnë se kapiteni i Francës, tashmë lojtar i Realit të Madridit, e ka hedhur në gjyq klubin francez për pagesa të padhëna. Flitet për 55 milionë euro që i përkasin rrogës dhe shpërblimeve. Konkretisht, Mbappe ankohet për mosdhënien e tre muajve të fundit të rrogës dhe të një të tretës së bonusit të përcaktuar sipas kontratës. Paris SG kërkoi një marrëveshje pa shkuar në gjyq, dhe i dërgoi ndërmjetës ish-yllit të ekipit, por kjo iniciativë u hodh poshtë nga ai. Mbappe i është drejtuar UEFA-s dhe pritet nisja e procesit legal për të zgjidhur këtë konflikt. Kapiteni i Francës u largua nga PSG-ja në fund të këtij sezoni, kur i përfundoi kontrata, dhe u prezantua në stadiumin "Santiago Bernabeu" të Madridit. Ai shpreson që në Spanjë ta fitojë Ligën e Kampionëve dhe trofe të tjerë në nivel evropian dhe botëror, diçka që nuk e bëri dot te parisienët.

Arteta rinovon kontratën me Arsenalin

Mikel Arteta - Arsenal kanë krijuar një lidhje shumë të fortë ndërmjet tyre, me palët që janë të kënaqur me bashkëpunim këtë periudhë aq sa kanë vendosur ta rinovojnë

kontratën aktuale. Sipas medieve angleze, Arteta ka pranuar ofertën e fundit të ardhur nga drejtuesit e klubit, ka firmosur një kontratë të re deri më 2027, aktualja përfundonte

më 2025. Gjithnjë sipas medieve, zyrtarizimi pritet të bëhet brenda të dielës, përpara derbit të Londrës kundër Tottenham Hotspurit. Një vit më parë Arteta flirtoi edhe me

titullin në Premierë Ligë, por të gjithë besojnë se kjo është thjesht çështje kohe. Në dy vitet e fundit Arsenali është kualifikuar me shumë lehtësi në Ligën e

Kampionëve, ndërsa ekipi vijon të rifreskohet me elementë të rinj, siç ndodhi këtë verë ku u afruan lojtarë si Calafiori, Mikel Merino dhe Raheem Sterling.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
Eëb:qs.rks.gov.net

Qendra e Studentëve në Prishtinë shpallë : 13.09.2024

KONKURS

Për pranimin e studentëve në konvikte dhe ushqim në mensën e studentëve për vitin Akademik 2024/2025.

Aplikimi bëhet përmes sistemit **ONLINE**. Linku për aplikim është i publikuar në web faqen zyrtare të QS-së **qs.rks.gov.net** dhe në profilin zyrtar në facebook **Qendra e Studenteve-Prishtine**. Udhëzuesi për aplikim gjendet në linkun e shfaqur.

Studentët e rregullt të UP, kanë mundësi të aplikojnë veçmas për të fituar të drejtën për t'u ushqyer në mensën e studentëve.

Kriteret për të aplikuar janë të njëjta sikurse për aplikim për konvikt.

Për konviktet dhe mensën e QS-së kanë të drejtë aplikimi të gjithë studentët e rregullt në studime themelore, vendbanimi i të cilëve është 25 km e më larg nga Prishtina.

Kriteret për pranin dhe pikët e mundshme:

1. Studentët nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore me notë mesatare 9.00 dhe më largësi 25 km e më shumë nga Prishtina, pranohen në konvikte pavarësisht totalit të pikëve që fitojnë.

2. Studentët nga fakultetet e tjera me notë mesatare 9.5 dhe më largësi 25 km e më shumë nga Prishtina pranohen në konvikte pavarësisht numrit të pikëve të fituara.

3. Studentët për notë mesatare fitojnë (varësisht nga nota mesatare).....5 - 15 pikë

4. Largësia e vendbanimit nga Komuna e Prishtinës – pikët1 - 10 pikë

5. Studentët jashtë territorit të Republikës për largësi marrin.....15 pikë

Studentët me status të vaçant për pikë shtesë sipas kategorive:

1. student (fëmijë) i dëshmorit10 pikë

2. student (fëmijë) i prindit invalid të luftës5 pikë

3. student, prindi i të cilit është veteran i luftës3 pikë

4. student i prindit martir nga lufta4 pikë

5. student me aftësi të kufizuara6 pikë

6. student i të burgosurit, politik4 pikë

7. student me asistencë sociale4 pikë

Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës

8. dy e më shumë studentë nga një familje aplikant në QS3 pikë

Të gjithë studentët e këtyre kategorive të cilët përfitojnë pikë shtesë duhet që përmes sistemit ONLINE të ngarkojnë dokumentacionin e kërkuar (çertifikaten) nga Ministrit përkatse.

Tri kategorit në vazhdim në pamundsi të dokumentit të kërkuar më lart çertifikaten ose vërtetimin nga :

- Shfaqja e të Burgosurve Politik, zyra qendrore Prishtinë
- Shfaqja e personave me Aftësi të Kufizuara – Hendikos, zyra qendrore Prishtinë.
- Shfaqja e familjeve te deshmorëve – Selia qendrore ne Prishtinë.

•Studenti i prindit martir nga lufta, vendimi i MPMS dhe çertifikata e bashkësisë familjare.

• Studentët prindërit e të cilëve janë veteran e të cilët marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës e ngarkojnë çertifikaten e prindërve të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa studentët prindërit e të cilëve nuk marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës nuk kanë nevojë t'a bëjnë ngarkimin e çertifikatës së prindit veteran, sepse pikët ju llogariten nga vet sistemi nga të dhënat e MPMS.

Sqarim: Njoftojmë studentët se pikët e fituara nga nota mesatare, nga largësia, student i prindit invalid të luftës, studentëve me asistencë sociale pikët i llogarit vet sistemit online. Andaj nuk është e nevojshme që këto dokumente të ngarkohen gjatë aplikimit.

• Te kategoria dy e më shumë studentë nga një familje, aplikuesi për vendosje në QS me rastin e aplikimit studentit i dytë apo i tretë nga e njëjta familje, duhet të shkruaj nr. e letërnjoftimit të aplikantit të parë në opsionin e hapur për këtë kategori.

• Studentët nga radhët e komuniteteve duhet të ngarkojnë çertifikaten e lindjes në rastin e aplikimit për vende në konvikte.

• Konkursi mbetet i hapur deri me datën **19.09.2024** nga dita e shpalljes.

• Studentët që kanë thyer Rregulloret në fuqi në Qendrën e Studentëve nuk do të pranohen në konvikte.

• Në konvikte do të pranohen studentët me numrin më të madh të pikëve të fituara.

Publikimi i rezultateve bëhet me datë **26.09.2024** në tabelat e konvikteve dhe faqet zyrtare të QSP.

• Afati për ushtrimin e ankesave **ONLINE** është **27 – 28.09. 2024**.

• Publikimi i rezultateve të ankesave bëhet me datën **02.10.2024**.

Drejtoria e Qendrës së Studentëve, Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
Eëb:qs.rks.gov.net

Studentski centar u Prištini objavljuje: 13.09.2024

KONKURS

Za prijem studenata u domove i prehranu u studentsku menzu za akademsku godinu 2024/2025.

Prijava se vrši putem ONLINE sustava. Link za prijavu objavljen je na službenoj web stranici QS **qs.rks.gov.net** i na službenom Facebook profilu Studentski centar-Prishtina. Vodič za prijavu možete pronaći na prikazanoj poveznici.

Ove akademske godine, redovni studenti UP-a imaju mogućnost da se posebno prijave za sticanje prava na ishranu u studentskoj menzi.

Kriterijumi za prijavu na prava hrane su isti kao i za prijavu studentskog doma.

Broj studentia koji će dobiti hranu u menzi je 1500 studenata.

Kriteriji za upis i mogućí bodovi:

1. Studenti Medicinskog fakulteta, Tehničkog fakulteta i Fakulteta matematičko-prirodnih znanosti s prosječnom ocjenom 9,00 i udaljenošću od Prištine 25 km i više primaju se u studentske domove bez obzira na ukupan broj bodova.

2. Studenti s drugih fakulteta s prosječnom ocjenom 9,5 i udaljeni 25 km i više od Prištine primaju se u domove bez obzira na broj osvojenih bodova.

3. Učenici za prosječnu ocjenu zarađuju (ovisno o prosječnoj ocjeni)... .5 - 15 bodova

4. Udaljenost od općine Priština bodova

5. Studenti izvan teritorija Republike na udaljenost dobivaju.15 bodova

Studenti sa posebnim statusom za dodatne bodove prema kategorijama:

1. učenik (dijete) mučenika - 10 bodova

2. učenik (dijete) ratnog vojnog invalida 5 bodova

3. učenik, čiji je roditelj veteran rata 3 boda

Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës

3

4. učenik rata mučenik roditelj 4 boda

5. učenik s teškoćama u razvoju 6 bodova

6. zatvorenik student, politički4 boda

7. učenik sa socijalnom pomoći4 boda

8. dva učenika više iz jedne prijavljene obitelji u QS3 boda

Svi učenici ovih kategorija koji dobiju dodatne bodove moraju putem ONLINE sustava učitati potrebnu dokumentaciju (provjeru) sa:

- Udruženje političkih zatvorenika, sjedište u Prištini
- Udruženje osoba s invaliditetom - Hendikos, sjedište u Prištini.
- Student iz rata, student nestalog, student građanskog rata s invaliditetom, odluka MRSZ -a i svjedodžba obiteljske zajednice.

Studenti čiji su roditelji veterani i primaju platu iz Budžeta Republike Kosovo postavljaju uverenje roditelja izdato od strane Vlade Republike Kosova, dok studenti čiji roditelji ne primaju platu iz Budžeta Republike Kosova ne treba učitavati sertifikat roditelja veterana, jer je bodove obračunavano od samog sistema iz podataka Ministarstva prosvete.

Objašnjenje: Obavještavamo učenike da su izračunate bodove dobivene iz prosječne ocjene, s udaljenosti, učenika roditelja mučenika, učenika s ratnim vojnim invalidom, učenika ratnog vojnog invalida, učenika roditelja veterana i učenika s socijalnom pomoći putem mrežnog sustava. Stoga nije potrebno da se ti dokumenti učitavaju tijekom prijave.

U kategoriji dva ili više učenika iz jedne obitelji, podnositelj zahtjeva za smještaj u QS prilikom prijave drugi ili treći student iz iste obitelji, mora napisati ne. osobne iskaznice prvog podnositelja zahtjeva u otvorenoj opciji za ovu kategoriju.

• Natječaj ostaje otvoren do 19.09.2024. Od dana objave.

• Studenti koji su prekršili Pravilnik koji je na snazi u Studentskom centru neće biti primljeni u domove.

• Studenti s najvećim brojem osvojenih bodova bit će primljeni u domove.

Objavlivanje rezultata vrši se **26. 09. 2024.** u tablicama studentskih domova i službenim web stranicama QSP -a.

• Rok za podnošenje **ONLINE** žalbi je **27- 28.09. 2024.** godine.

• Objavlivanje rezultata pritužbi vrši se **02.10.2024.**

Uprava Studentskog centra, Priština



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 13.09.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Inkasant 1 pozitë

Vendi punës Klinë:
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjtit të punës.
Koefficienti i pagës 1.7

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.Bënë inkasimin nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht me fatura sipas rrugëve dhe tereneve.
- 2.Dorëzon kryerjen e pagesave me shënimet e duhura tek faturimi.
- 3.Dorëzon pazarin ditor te inkasuar ne arke.
- 4.Përcjell gjendjen në teren dhe regjistron kliente te rinje.
- 5.Është i obliguar që të përcjellë ndërrimin e pronareve, faturimi i dyfishte, pasivizimet, korrigjimet e adresave, dhe të merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave te inkasantit ne lidhje me terenin dhe i dorezon të shefi i inkasimit dhe faturimit.
- 6.Është i obliguar që për çdo parregullsi në fatura, t'i kthejë në rilllogaritje te shefi i Inkasimit dhe faturimit.
- 7.Obligohet që në teren të sillt korrekt dhe të mban uniform dhe shenjë identifikimi të Ndërmarrjes.
- 8.Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të shefit te Inkasimit dhe faturimit.
- 9.Për mos respektimin e pikave te lartecaktuara i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv

a.Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertifiata mbi gjendjen shendetsore

b..Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme
- Përparësi përvojë pune e deshmuar.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Pozita : Arkatar 1 pozitë

Vendi punës Klinë:
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjtit të punës.
Koefficienti i pagës 2.1

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 1483

DATA 12.09.24



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në dy kopje, kopjen e pare ia dorëzon pales.
- 2.Për secilën pagesë mban kopje si dëshmi të nënshkruara nga dy palët;
- 3.Të hyrat e gatshme i dorëzon në bankë-xhiro llogarin e Ndërmarrjes, pa vonesë.
- 4.Përpilon ditarin e arkës për çdo ditë mbi të hyrat dhe të dalurat dhe ia bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar.
- 5.Çdo pagesë e evidenton në urdhëresat "Arketim-Pagese".
- 6.Është i obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve financiare të arkës për të cilin bjen vendim kontabilistit.
- 7.Kujdeset për mjetet e pranuar duke i verifikuar me pajisje adekuate;
- 8.Duhet pasur kujdes çdo herë në identifikimin e klientit, regjistrimin dhe numërimin e parave dhe regjistrimin e pagesave në kompjuter, Bën postimin e raporteve në fund të orarit në baza ditore direkt në sistem;
- 9.Pranon informata të ndryshme dhe ankesat lidhur me problemet e konsumatorëve dhe për të njëjtat e njofton shefin e inkasimit dhe faturimit.
- 10.Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të kontabilistit.
- 11.Për mos respektimin e pikave te lartecaktuara i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv

a.Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertifiata mbi gjendjen shendetsore

b..Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme, përparësi Diplome Universitare
- Përparësi përvojë pune e deshmuar.
- njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 13.09.2024 deri me 30.09.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lulvera Jashari shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM "Xheladin Deda".

- Resmije Rama shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore Xhevat Jusufi ish shkolla fillore "Rifat Vidishiqi".

- Qerfime Rama shpal te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Xhevat Jusufi" ish shkolla fillore "Rifat Vidishiqi".

- Bedrije Deliu shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme "Frang Bardhi".

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari".

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



SHALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Mbikëqyrës i Lartë i Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik (dy pozita)
Grada e pozitës:	5
Kohëzgjatja e punësimit:	Me afat të pacaktuar
Divizioni:	Mbikëqyrja e Sistemeve të TI-së
Raportin tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësi:

Përmbledhje e Pozitës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është në kërkim të një kandidati të kualifikuar dhe të motivuar për pozicionin e Mbikëqyrës të Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik në Divizionin e Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së. Ky rol është thelbësor për të siguruar që institucionet financiare nën autoritetin tonë rregullator të mbajnë sisteme informacioni dhe korniza sigurie kibernetike të qëndrueshme, të sigurta dhe në përputhje me kërkesat rregullative. Kandidati i suksesshëm do të jetë pjesë e një ekipe përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rreziqeve të TI-së dhe atyre kibernetike në sektorin financiar, duke siguruar që institucionet përmbushin kërkesat rregullative dhe praktikatat më të mira.

Përgjegjësitë Krvesore

- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i sistemeve të informacionit dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut kibernetik brenda institucioneve financiare për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat rregullative.
- Kryerja e vlerësimeve të rrezikut të TI-së dhe atyre kibernetike, identifikimi i dobësive, kërcënimeve dhe ndikimeve të mundshme në stabilitetin financiar të institucioneve.
- Sigurimi që institucionet e mbikëqyrura të jenë në përputhje me kërkesat rregullative të aplikueshme në vend të sigurisë kibernetike dhe TI-së.
- Monitorimi dhe vlerësimi i përgjigjes së institucioneve ndaj incidenteve kibernetike, duke ofruar udhëzime dhe rekomandime për të zvogëluar rreziqet dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre.
- Bashkëpunimi me palët e interesit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë institucionet financiare, ekspertët e industrisë dhe agjencitë qeveritare, për të promovuar qëndrueshmërinë kibernetike në të gjithë sektorin.
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve mbi vlerësimet e rrezikut të TI-së dhe atij kibernetik për menaxhmentin e lartë, duke theksuar gjetjet kryesore, rekomandimet dhe fushat me shqetësime.
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Shkallë bachelor në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit, Siguri Kibernetike, Shkenca Kompjuterike ose një fushë të ngjashme. Certifikimet përkatëse si CISSP, CISM ose CISA janë shumë të dëshirueshme.
- Së paku 3 vite përvojë në mbikëqyrjen e TI-së, auditim të TI-së, sigurinë kibernetike ose role të ngjashme, preferohet në industrinë e shërbimeve financiare ose në një autoritet rregullator.
- Njohuri mbi sistemet e informacionit, qeverisjen e sistemeve të informacionit, kornizat e sigurisë kibernetike, praktikatat e menaxhimit të rrezikut dhe përputhshmërinë me rregullativën në sektorin financiar.
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe zgjidhje problemesh, me aftësinë për të vlerësuar çështjet komplekse të sistemeve të informacionit dhe atyre kibernetike dhe për të zhvilluar zgjidhje praktike.
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar.
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- Njohuri të rregulloreve, standardeve dhe udhëzimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e TI-së dhe sigurinë kibernetike.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomatat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **27 shtator 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Viši supervizor IT sistema i sajber rizika (dve pozicije)
Stepen pozicije:	5
Trajanje zaposlenja:	Na neodređeno vreme
Odsek:	Nadzor nad IT sistemima
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za nadzor nad IT sistemima

Pregled dužnosti i odgovornosti:

Sažetak pozicije

Centralna banka Republike Kosovo traži kvalifikovanog i motivisanog kandidata za poziciju supervizora IT sistema i sajber rizika u Odseku za nadzor nad IT sistemima. Ova uloga je od suštinskog značaja kako bi se osiguralo da finansijske institucije pod našim regulatornim autoritetom održavaju stabilne, bezbedne i usklađene informacione sisteme i okvire sajber bezbednosti i koje su u skladu sa regulatornim zahtevima. Uspešan kandidat biće deo tima odgovornog za nadgledanje i procenu IT i sajber rizika u finansijskom sektoru, osiguravajući da institucije ispunjavaju regulatorne zahteve i najbolje prakse.

Glavne dužnosti

- Nadgledanje i procena informacionih sistema i prakse upravljanja sajber rizikom u finansijskim institucijama kako bi se osigurala usklađenost sa regulatornim zahtevima.
- Sprovođenje IT i sajber procena rizika, utvrđivanje slabosti, pretnji i potencijalnih uticaja na finansijsku stabilnost institucija.
- Osigurati da nadzirane institucije budu u skladu sa regulatornim zahtevima koje se primenjuju u zemlji o sajber bezbednosti i IT-u.
- Praćenje i procena odgovora institucija na sajber incidente, kroz davanje smernica i preporuka za smanjenje rizika i sprečavanje njihovog ponavljanja.
- Saradnja sa internim i eksternim zainteresovanim stranama, uključujući finansijske institucije, eksperte iz industrije i vladine agencije, radi promocije sajber otpornosti u celom sektoru.
- Pripremanje i predavljanje izveštaja o IT i sajber procenama rizika višem rukovodstvu, naglašavajući ključne nalaze, preporuke i područja zabrinutosti.
- Ostale dužnosti koje odredi nadređeni.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Bachelor diploma u smeru informacione tehnologije, sajber bezbednosti, računarskim naukama ili srodnoj oblasti. Veoma su poželjni relevantni sertifikati kao što su CISSP, CISM ili CISA.
- Najmanje 3 godine iskustva u IT nadzoru, IT reviziji, sajber bezbednosti ili sličnim ulogama, po mogućnosti u industriji finansijskih usluga ili u regulatornom telu.
- Poznavanje informacionih sistema, upravljanja informacionim sistemima, okvira sajber bezbednosti, praksi upravljanja rizicima i usklađenosti sa propisima u finansijskom sektoru.
- Odlučne analitičke veštine i veštine rešavanja problema, sa sposobnošću procene složenih informacionih sistema i sajber problema i razvijanja praktičnih rešenja.
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.
- Poznavanje nacionalnih i međunarodnih propisa, standarda i smernica vezanih za IT i sajber bezbednost.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propatno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije koju ste imali i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova (Trust)** za relevantni period, ili poresku potvrdu Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Zadnji rok za podnošenje prijave je **27 septembar 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

